**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KOMUNA DRENAS**
**Zyra e Kryetarit**
**Zyra për Integrime Evropiane**
**01 Nr. 052- 71847 datë : 19.12.2019**

| | |
|---|---|
| **Për :** | **Rozafa Ukimeraj, Sekretare e përgjitshme MAPL** |
| **Përmes :** | **Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës,** |
| **Nga :** | **Gentianë Morina, Zyrtare për Integrime Evropiane** |
| **Lënda :** | **Raportimi i komunave për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane për periudhën janar-dhjetor 2019** |

Të nderuar/a,

Duke u bazuar në shkresën e datës 04.12.2019 drejtuar Kryetarëve të Komunave lidhur me Raportimin e komunave për përmbushjen e obligimeve të cilat dalin nga Agjenda Evropiane për periudhën janar-dhjetor 2019 duke pasur parasysh Programin Kombëtar për zbatim të MSA-së i cili është një dokument ligjërisht i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Kosovës, ju njoftojmë se Komuna e Drenasit përkatësisht Zyra për Integrime Evropiane gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2019 ka koordinuar, monitoruar dhe raportuar rreth përmbushjes së obligimeve nga agjenda evropiane me të gjithë drejtorët, shefat dhe zyrtarët e Komunës së Drenasit.

Të bashkangjitur gjeni edhe formularin e plotësuar për raportim nga Komuna e Drenasit për përmbushjen e obligimeve të cilat dalin nga Agjenda Evropiane për periudhën janar – dhjetor 2019.

Drenas/Gllogoc
Datë: 19.12.2019

**OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE**
**PLANI GJITHPËRFSHIRËSE I KOMUNAVE 2019**

| | | |
|---|---|---|
| **Data e dorëzimit të raportit:** | | |
| **Emri i komunës** | Gllogoc | |
| **Emri i Kryetarit të Komunës** | Ramiz Lladrovci | |
| **Emri i Zyrtarit Komunal për IE :** | Gentianë Morina/ Me autorizim | |
| **Detajet kontaktuese:** | **E-mail:gentiane.r.morina@rks-gov.net**<br>**Tel: 049/978-926** | |
| **Informata të përgjishme mbi zhvillimin e proceseve të Integrimeve Evropiane në komunen tuaj?** | 1. A është themeluar zyra komunale për Integrime Evropiane në komunën tuaj konform Rregullores Nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për Integrim Evropian?<br>2. A vepron ZKIE në kuadër të Zyrës së Kryetarit?<br>3. A e ka udhëheqësin e zyrës ZKIE-a?<br>4. Sa zyrtarë janë në këtë zyre?<br>5.A ka zyrtari/zyra komunal për integrime Evropiane plan vjetor të punës ?<br>4. A ka ndonjë mekanizëm tjetër komuna juaj (p.sh grup punues) nga drejtoritë përkatëse të cilat janë të obliguara të raportojnë në obligimet e Agjendes Evropiane në të cilat diskutohen arritjet dhe sfidat e përmbushjes së obligimeve nga Agjenda Evropiane në komunën tuaj, nëse po sa takime janë mbajturë gjatë kësaj periudhe ?<br>5.Obligimet e komunës suaj të cilat dalin nga Agjenda Evropiane, a janë të inkorporuara në planin vjetore të Drejotorive përkatëse si dhe | 1.po, Komuna ka të themeluar Zyrën për Integrime Europiane ashu siç parashihet me Rregulloren nr.08/2011 Mbi organizimin dhe përgjegjesitë e Zyrave Komunale për Integrime Europiane.<br>2.Po ZKIE vepron në kuader të Zyrës së Kryetarit.<br>3.ZKIE ka të emëruar Zyrtarin për Integrime Europiane.<br>4. Një (1) Zyrtar për Integrime Europiane.<br>5. Po , ka plan vjetor të punës.<br>4.Bazuar në Rregulorën nr.08/2011 behët kordinimi, monitorimi, raportimi rreth përmbushjes së obligimeve nga agjenda europiane me të gjithë drejtorët, shefat dhe zyrtarët komunal.<br>5.Po,obligimet e Komunës të cilat dalin nga agjenda europiane janë të inkorporuara në planin vjetor të |

| | | |
|---|---|---|
| | a është ndarë buxhet për realizimin e këtyrë obligimeve?<br><br>6.A merr pjesë Zyrtari për Integrime Evropiane në takimet që mbahen për planifikim të buxhetit vjetor/ në mënyre që të ketë një monitorim më efikas mbi përfshirjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane në planet e punës se drejtorive Komunale dhe planifikimin buxhetor të atyre planeve . | Drejtorive përkatëse.<br><br>6.Po, Zyrtari për Integrime Europiane në takimet që mbahen për planifikim të buxhetit vjetor merr pjesë në mënyre që të ketë një monitorim më efikas mbi përfshirjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane në planet e punës se drejtorive Komunale dhe planifikimin buxhetor të atyre planeve . |

| **Objektivat** | **Drejtoria komunale përgjegjëse** | **Masat** | **Përmbledhja e aktiviteteve të kryera gjatë periudhës së raportimit Janar – Qershor 2019** | **Dispozitat e MSA-së** |
|---|---|---|---|---|
| **1. <u>BLLOKU I: KRITERET POLITIKE</u>** | | | | |
| **1. ADMINISTRATA PUBLIKE** | | | | **Neni 120 i MSA-së: Administrata publike** |
| 1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal | **Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ Zyrat dhe Sektorët** | 1. A është hartuar programi trajnimeve për vitin 2019 në komunën tuaj? Nëse po, ju lutemi të ofroni një dokument të tillë. Nëse jo, ju lutem shpjegoni arsyet.<br><br>2. Sa është numri trajnimeve të mbajtura sipas fushave dhe numri i zyrtarëve të trajnuar ? | 1.Po, është hartuar plani vjetor i trajnimeve për nëpunësit civil për periudhen Janar-Dhjetor 2019.<br>2.Trajnimet e mbajtura :<br>-Konflikti i interesit në administraten publike/2 Zyrtar<br>-Hartimi i legjislacionit/2 Zyrtar<br>-Microsoft Access 2013/5 Zyrtar<br>-Menagjimi i pronave publike/4 Zyrtar<br>-Politika e BE-se,trendet e globalizmit dhe zhvillimet rajonale/3 Zyrtar<br>-e-Qeverisja dhe m-Qeeverisja/2 Zyrtar<br>-Menaxhimi i burimeve njerëzor/5 zyrtarë<br>-Sinjalizuesit dhe e drejta e tyre /2 zyrtarë | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 3.A posedon komuna juaj databazën për meaxhimin e programit të trajnimeve?<br><br>4.Sa zyrtarë të rinjë janë punësuar në administratën e Komunës suaj gjatë periudhës raportuese. Ju lutemi ofroni listën e të punësuarve, pozitat e tyre dhe departamentet/ zyrat në të cilat janë punësuar? | -Menaxhimi i taksave dhe të hyrave vetanake /4 zyrtarë<br>-Cikli i menaxhimit të projekteve në nivel lokal/2 zyrtarë<br>-Menaxhimi i sistemit të planifikimit të integruar në qeverisjen lokale /2 zyrtarë<br><br>3.Zyra personelit harton planin e trajnimeve për çdo vit.<br><br>4.Gjithsej 18 Zyrtarë të rinjë janë punësuar.<br>-,Z. për Ndriqim Publik dhe z.për menaxhimin e mbeturinave,/DSHPE,-Zyrtar Prokurimi 1,2 dhe 2 z. për gjendje civile /DAP,Zyrtar Personeli 1dhe z.për informim dhe monitorim të mediave/Zyra e Kryetarit, Z. për Listat e pagave z.për menaxhimin e projekteve /DKA,z.i lartë për ekonomi dhe z.për zhvillim/DZHE,Z.për shëndetesi dhe 3 z.për shërbime sociale/DSHMS,3 z, për ndërtimtari/DIP,arkëtar,z.për mbledhjen e tatimit dhe ZKF/DBF, z.për bibliotekë/DKRS. | |
| 1.2.Të zbatohet legjislacioni dhe politikat për reformën e administratës publike | **Zyra e personelit** | 1. A ka bërë komuna juaj përgatitje gjatë periudhës raportuese për zbatimin e tri ligjeve kornizë për reformën e adminsitratës publike (*Ligjit për zyrtarët publikë, Ligjit për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura*, dhe *Ligjit për Pagat në Sektorin Publik*)? Ju lutemi ofroni të dhëna mbi aktivitetet e ndërmarra.<br><br>2. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për | 1.Po, Komuna me qëllim të arrij zbatimin sa më të saktë të Ligjeve ka dërguar në trajnim Zyrtarë nga Komuna në mënyrë që ti përcjellë ndryshimet në legjislacion dhe të këtë efikasitet në zbatimin e Ligjeve,pjesëmarrje e zyrtarëve në mbledhjet e organizuara nga Asociacioni i Komunave .<br><br>2.Komuna për çdo vit dërgon zyrtarët në trajnime te organizuara nga niveli qendror lidhur me përmiresimin e menaxhimit të financave publike, dhe bën raporte javore, mujore dhe qdo 3 muaj per menaxhimin e financave publike. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ngritjen e kapaciteteve institucionale për përmirësimin e menaxhimit të financave publike? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra.<br><br>3. Sa rekomandime ka dhënë Zyra Kombëtarë e Auditimit (ZKA) në raportin më të fundit për Komunën tuj. Sa rekomandime të ZKA-së i keni adresuar dhe sa prej tyre kanë mbetur pa u adresuar? Ju lutemi shpjegoni.<br><br>4. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për përmirësimin e transparencës dhe qeverisjes së ndërmarrjeve publike që funksionojnë në territorin e komunës suaj? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra. | 3.Rekomandimet lidhur me Procesin i buxhetit, të hyrat, Menaxhimi i personelit,subvencionet dhe transferet,Investimet Kapitale,Obligimet e papaguara. Është formuar Grupi punues për zbatimin e Rekomandimeve nga ZKA ndërsa për pjesën e auditimit të kryer në nëntor nuk është njoftuar ende Komuna nga ZKA lidhur me auditimin e kryer.<br><br>4. Komuna jonë me qëllim të përmirësimit të transparencës çdo raport e publikon ne web faqën e Komunës dhe tabelën e shpalljeve në Komunë, po ashtu në fillim të vitit ka miratuar në Kuvendin Komunal Planin për përmbushjen e transparencës si dhe me 29.11.2019 në mbledhjen e Kuvendit Komunal është miratuar me disa ndryshime edhe Regullorja Komunale për Transparencë. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1.3.Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal | **Drejtoria e Administratë s/Sektori i Kuvendit/ Zyra për Informim/** | 1. A ka hartuar komuna juaj Startegjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, nëse po ju lutem të bashkangjiteni strategjinë e miratuar?<br><br>2.Sa është numri i kërkesave për qasje në dokumente publike?<br><br>3. Sa është numri i kërkesave të aporvuara për qasje në dokumente publike?<br><br>4. Sa është numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike?<br><br>5. A janë publikuar në ueb faqen e komunës tuaj të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga organet e komunave në gjuhët zyrtare (nëse jo, ju lutem jepni arsyet e mos publikimit në gjuhët zyrtare) ?<br><br>6. A janë duke u transmetuar mbledhjet e | 1.Është punuar në Draft-Strategjinë për Komunikim me Publikun, por nuk është e miratuar ende .<br><br>2.Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike është 18 kërkesa janar-qershor, ndërsa qershor-dhjetor 34 kërkesa.<br><br>3.Gjithsej 52 kërkesa kanë qenë të qasshme gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2019.<br><br>4.Nuk ka kërkesa të refuzuara, pasi të gjitha kërkesat për qasje publike janë aprovuar dhe kanë qenë të qasshme.<br><br>5.Aktet dhe dokumentet e nxjerra nga organet e Komunës janë publikuar të gjitha në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën serbe pjesërisht për shkak të mungesës së zyrtarëve për përkthim.<br><br>6.Po, mbledhjet e kuvendit transmetohen përmes web faqes komunale. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | kuvendeve perms ueb faqes komunale ? | | |
| | | 7. A ka forma të tjera të transmetimit të mbledhjeve të kuvendeve ? | 7.Po , përmes kanalit You Tube. | |
| | | 8. Sa takime publike gjithëpërfshirëse me qytetarë janë mbajtur gjatë peridhës raportuese (konform nenit 68.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale)? [1] | 8.Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjithsej 2 takime. | |
| | | 9. Sa takime konsultative me qytetarë janë mbajtur lidhur me propozim-aktet e kuvendit të komunës (rregullore, statute, plane etj)? | 9. Lidhur me propozim –aktet e Kuvendit të Komunës janë mbajtur 16 takime konsultative me qytetarë. | |
| | | 10.A ka ndërmarrë Komuna juaj veprime për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në Konsultime publike? Nëse po qfarë veprime ka ndërmarrë? | 10. Përvec njoftimeve përmes web faqes zyrare komunale , rrjetit social Facebook dhe portaleve, kur thirren konsultimet publike, kontaktojmë edhe përmes telefonit kryetarët e fshatrave dhe përfaqësuesve të lagjeve, në mënyre që të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në këto konsultime. | |

[1] Neni 68.1 I Ligjit për vetëqeverisje lokale obligon së paku 2 takime publike në vit në të cilat mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 11.Cilat janë vështirësitë të cilat ndikojnë në zbatimin e ligjeve, Rregulloreve, politikave dhe procedurave tjera në Komunën tuaj? Cilat janë veprimet që ka ndërmarrë komuna juaj në këtë drejtim? | 11.Si vështirësi të cilat ndikojnë në zbatimin e ligjeve mbetet interesimi i ulët i qytetarëve që të marrin pjesë në këto takime për hartimin e dokumenteve strategjike, pavarësisht njoftimit publik që bëhet për këto takime me interes për qytetarët. | |
| 1.5.Të zbatohet në mënyrë sistematike rekrutimi i stafit civil i cili është bazuar me ligj | **Drejtoria e Administratës/Zyra e personelit** | 1. A është themeluar komiteti për komunitete në komunën tuaj konform Ligjit për Barazi Gjinore (nenit 6 paragrafi 7 dhe 8).<br><br>2. Sa mbledhje të këtij komiteti janë mbajtur në periudhën raportuese?<br><br>3. A është emëruar nënkryetari i komunës për komunitete?<br><br>4.A eshte ndërmarr ndonje veprim per te ndaluar ndikimin politik në rekrutimin e pozitave | 1.Po ,është i themeluar Komiteti për Komunitete konform Ligjit për Barazi Gjinore. .<br><br>2.Gajtë kësaj periudhe raportuese Komiteti për komunitete ka mbajtur 3 mbledhje .<br><br>3.Jo.<br><br>4.Komisionet vlerësuese të cilat emërohen nga ZKA për zhvillimin e procedurave rektutuese | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | të larta të shërbimit civil dhe rekrutimet jo-meritore? Nëse po, cilat janë veprimet?<br><br>5.Sa është përqindja e popullësisë jo shumicë në komunën tuaj ?<br><br>6. Sa është përqindja e të punësuarave të komuniteteve jo shumicë në institucionet publike? | janë të paanshëm dhe të pavarur në punën e tyre.<br><br>5. Nuk ka.<br><br>6. Nuk ka . | |
| **2. AVOKATI I POPULLIT** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2.1.Të përmirësohen kushtet për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit | **Drejtoria e Administratës** | 1.Sa ëshë numri i insitucioneve publike lokale në komunen tuaj?<br>2. Sa prej tyre kanë qasje të përshtatshme për persona me aftësi të veçanta? | 1.34 institucione arsimore, institucione shëndetsore 13, objekti komunal dhe 5 zyre të gjendjes civile,zyra e punësimit , dega e zyrës nga MPB, Dega e Gjykatës Themelore.<br>2.Të gjitha kanë qasje të përshtatshme për persona me aftësi të veçanta, me perjashtim të disa QMF dhe AMF janë duke e realizuar qasje të përshtatshme. | |
| 2.2. Të zbatohen rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** | 1.Sa është numri i kërkesave/rekomandimeve të cilat Komuna i ka pranuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit ( nëse po listoni ato), si dhe cilat janë masat që komunat kanë ndërrmarë lidhur me rekomandimet e pranuara?<br>2. Sa përgjigje pozitive i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?<br>3. Sa përgjigje negative i ka kthyer Komuna | 1.Komuna e Gllogoc/it këtë periudhë raportuese ka pasur 2 kërkesa për shqyrtim nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe brenda afateve ligjore i është kthyer përgjigjja.<br>2.Komuna e Drenasit ka pasur dy kërkesë për shqyrtim të ciliës i ka kthyer përgjigje pozitive.<br>3. Asnjë, ngaqë vetëm dy kërkesë e kemi pasur të cilës i kemi kthyer përgjigje pozitive. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Institucionit të Avokatit të Popullit?<br><br>4.Sa kërkesa/rekomandime janë në proces të shqyrtimit? | 4. Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kemi asnjë kërkesë/rekomandim në proces të shqyrtimit. | |
| **3.SHOQËRIA CIVILE** | | | | |
| 3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile | **Drejtoria për Financa dhe Buxhet** | 1. Sa ka ndarë buxhet komuna për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve ?<br><br>2.Sa është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna?<br><br>3.Sa është numri i | 1.Komuna e Drenasit për vitin 2019 ka ndar mjete në vlerë prej:60,000 € per D.Kultur Rini dhe sport.Bujqësia me 50,000.00 € Shendetësia me 26,347.00 €,Arsimi me 80,000.00€,gjithësejt 231,347.00 € nga buxheti i vitit 2019 dhe bartje nga viti i kaluar shuma prej:23,854.56 € dmth 255,201.56 €<br><br>2.Numri i oshc-ve të cilat kanë perfitu nga komuna janë:17 organizata duke filluar nga | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | projekteve që ka financuar komuna?<br><br>4.Sa është shuma e përgjithshme e realizuar për përkrahjen e aktiviteve të OSHC-ve? | ditet e mergatës organizime të ndryshme,mbeshtetje për kulturë, sport, rini dhe letersi.<br><br>3.Komuna ka mbeshtet 17 projekte të ndryshme. Ne sektorin e Bujqësisë kan perfitu 100 Bujqë motokultivator me freza(100 cop), dhe 93 sera,fidane të bimëve mjekuese aromatike,ne blegtori me koshere bletesh,ne Sektorin e arsimit janë ndar 160 bursa për student dhe nxenes.Në shendetësi janë parapa perkrahja e familjev skamnore me pako ushqimore në vlerë pre 26,347.00 €<br><br>4.Shuma e pergjithshme e realizuar deri me tani është:130,158.28 (ekzekutuar) euro dhe pjesa tjeter është në procedur, sepse pagesat nuk janë ekzekutuar akoma. | |
| **4.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT** | | | | **Neni 92: Lufta kundër terrorizmit - MSA** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.1.Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre | **Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës** | 1. Cilat janë veprimet/ aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm ?<br><br>2. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?<br><br>3. A është kërkuar nga Drejtori i Policisë për të raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë në Kuvendin e Komunës dhe a është raportuar ? | 1.Në mbledhjet e KKSB-së janë diskutuar çështje që kanë të bëjnë me siguinë e përgjithshme në Komunën e Gllogoc-it. Gjatë këtij viti gjithsej janë mbajtur 6 takime të KKSB-së, poashtu Komuna ka trupa për siguri dhe KLSP-të që kanë mbajtur katër takime ku janë diskutuar cështje të ndryshme që prekin sigurinë e përgjithshme të Komunës së Drenasit.<br><br>2. Nuk është raportuar për ndonjë çështje të ekstremizmit, por për çështje të sigurisë së përgjithshme siç janë : shqetësimi për vjedhje, qentë endacak, zjarret etj.<br><br>3. Jo | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.2.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit , si dhe për zbatimin e politikave të tjera kundër korrupsionit | **Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës** | 1.Sa është numri i personave zyrtar të obliguar për deklarimin e pasurisë tek AKK?<br><br>2.Sa është numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal ?<br><br>3. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës?<br><br>4. A ka bërë komuna juaj përgatitje gjatë periudhës raportuese për zbatimin e ndryshimeve më të fundit ligjore për suspendimin e zyrtarëve të dyshuar për korrupsion, respektivisht atyre të dënuar, për korrupsion (bazuar në ndryshimet më të fundit në *Kodin Penal* dhe atë të *Procedutrës penale*)? Ju lutemi ofroni të dhëna mbi aktivitetet e ndërmarra.<br><br>5. A ka bërë komuna juaj | 1.Numri i personave zyrtar të cilet janë të obliguar për deklarimin e pasurisë tek AKK është 47 zyrtarë.<br>ka deklarime të konfliktit të interesit.<br><br>2.Nuk ka .<br><br>3.Nuk ka anëtarë të cilët kanë deklaruar konflikt të interesit.<br><br>4. Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kemi ndonjë zyrtar të suspenduar për korrupsion, por Komuna përcjellë vazhdimisht ndryshimet në legjislacion dhe kujdeset për zbatimin e ligjit.<br><br>5.Gjatë kësaj periudhe Komuna ka dërguar zyrtar në trajnim për të përcjellur ndryshimet në legjislacionin për konflikt të interesit në | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | përgatitje gjatë periudhës raportuese për zbatimin e ndryshimeve më të fundit në legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës zyrtare? Ju lutemi ofroni të dhëna mbi aktivitetet e ndërmarra.<br><br>6. A ka bërë komuna juaj përgatitje gjatë periudhës raportuese për zbatimin e ndryshimeve më të fundit në legjislacionin për mbrojtjen e informatorëve? Ju lutemi ofroni të dhëna mbi aktivitetet e ndërmarra. | ushtrimin e detyrës zyrtare si dhe ka emëruar Zyrtarin për zgjidhjen e çështjeve për konflikt të interesit.<br><br>6.Komuna e Gllogocit gjatë periudhës raportuese ka emëruar Zyrtarin për sinjalizim duke u bazuar në Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve . | |
| 4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion; | **Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës** | 1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet, nëse po ju lutem të bashkangjiteni planin e miratuar?<br><br>2. A ka komuna juaj zyrtar që raporton për Planin Lokal për Integritet ?<br><br>3. Sa është numri i | 1.Po, Komuna e Gllogoc-it ka hartuar Planin Lokal për Integritet. https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2018/04/Plani-i-Integritetit-pjesa-e-dyt%C3%83%C2%AB.pdf<br><br>2.Po, Komuna ka emëruar Zyrtarin që raporton për Planin Lokal për Integritet.<br><br>3.Dy raporte të publikuara mbi monitorimin e | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | raporteve të publikuara mbi monitorimin e zbatimit të Planit Lokal për Integritet. | zbatimit të Planit Lokal për Integritet. | |
| **5. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE** | | | | |
| 5.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** | 1.Numri dhe lloji i aktiviteteve të komunës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut?<br><br>2. A është miratuar rregullorja komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nëse po ju lutem të bashkangjiteni rregulloren e miratuar?<br><br>3. A ka rritur komuna juaj buxhetin e ndarë për këtë | 1.Organizimi i aktiviteve dhe pjesëmarrja në punëtori për promovimin e të drejtave te njeriut si : 8 Marsi, 1 Qershori Dita ndërkombëtare e fëmijeve, aktivitete lidhur me dhunën në familje, pjesëmarrje në punëtori lidhur me të drejtën në trashëgimi, mbështetja e masës afirmative për regjistrimin e pronës në emë të dy bashkëshortëve etj.<br><br>2.Po, është miratuar Rregullorja komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2018/11/rregullorja.pdf<br><br>3.Në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme ndahet edhe buxheti për | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | vit për zbatimin e politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejave të njeriut dhe të minoriteteve në raport me vitin 2018? Nëse po, ju lutemi ofroni të dhënat (në shifra absolute dhe përqindje). Nëse jo, ju lutemi shpjegoni arsyet.<br><br>4. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për forcimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteeve? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra.<br><br>5. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për ngritjen e kapaciteteve institucionale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteeve? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra. | realizimin aktivitetet të cilat i realizon Zyra për Barazi Gjinore prej pozicionit të subvencioneve, mirëpo Komuna e mbështet dhe mirëpret zbatimin e politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejave të njeriut dhe të minoriteteve.<br><br>4.Komuna gjatë kësaj periudhe raportuese ka dërguar në trajnime përkatëse Zyrtarin përkatës për Barazi Gjinore për të ndjekur trajnime dhe punëtori nga fusha e të drejtave të njeriut të organizuara nga ABGJ,OSBE-ja si dhe OJQ të tjera.<br><br>5.Komuna e Gllogoc-it siç jeni edhe ju në dijeni përbehët vetëm nga popullsia shqiptare, megjithatë Komuna është kujdesur që të promovoje të drejtat e njeriut duke organizuar dhe marrë pjesë në punëtori lidhur me ngritjen e kapaciteteve institucionale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| 5.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** | 1. A ka hartuar komuna juaj Strategjinë kundër dhunës në familje, nëse po ju lutem të bashkangjiteni Startegjinë e miratuar?<br><br>2. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit të Strategjisë kundër dhunës në familje, nëse po ju lutem të bashkangjiteni këtë Plan ?<br><br>3. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj?<br><br>4.A ka themeluar komuna këshillin komunal për mbrojtën e viktimave te dhunës ne familje dhe baza gjinore, nëse po sa takime janë mbajtur?<br><br>5. A ka rritur komuna juaj | 1.Nuk ka Strategji të Dhunës në Familje.<br><br>2.Nuk ka Plan te Veprimit të Strategjisë kundër dhunës në familje .<br><br>3.Qendra për punë sociale gjatë periudhës janar-qershor 2019 ka trajtuar 20 raste të dhunës në familje.<br><br>4.Nuk ka. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | buxhetin e ndarë për këtë vit për zbatimin e politikave për barazi gjinore në raport me vitin 2018? Nëse po, ju lutemi ofroni të dhënat (në shifra absolute dhe përqindje). Nëse jo, ju lutemi shpjegoni arsyet.<br><br>6. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për ngritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin e politikave për barazi gjinore? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra. | 5 . Po.<br><br>6. Më qëllim të arritjes së barazisë gjinore Komuna jonë ka zhvilluar politika të tilla ku 6 pozita menaxheriale/Drejtori Komunale udhëhiqen nga femrat, si dh kujdeset që që të respektohet kuota gjinore në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore duke ju ofruar qasje dhe shërbime të gjithëve pa dallim. | |
| 5.4.Të fuqizohet roli dhe pozita e femrës në shoqëri | **Njësia për të Drejtat e Njeriut** | 1. Sa është numri i femrave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj)?<br><br>2.Sa është numri total i përfaqësimit të femrave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, | 1.Numri i femrave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet është 25. Drejtoresha të shkollave 10, administratë komunale shefe sektori 10, shëndetesi 5, ndërsa staf politik janë 6 Drejtori Komunale të cilat udhëhiqen nga femrat.<br><br>2.Numri total i përfaqësimit të femrave në administratën publike lokale është 55 ndërsa në Kuvendin Komunal 11. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë ?<br><br>3.A ka ndërmarrë Komuna juaj ndonjë veprim për rritjen e përfaqësimit të grave në pozitat lokale të vendimmarrjes. Nëse po cilat janë ato? | 3.Veprimet të cilat i ka ndërmarrë Komuna më qëllim të përfaqesimit të grave në pozitat lokale është respektimi i Ligjit për Barazi Gjinore ku nga gjithsej 12 Drejtori që janë 6 prej tyre udhëhiqen nga femrat. | |
| 5.5.Zbatimi i të drejtave pronësore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/ Zyra për Barazi Gjinore** | 1. Cilat janë veprimet që ka ndërrmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre? | 1.Zyra për Barazi/Komuna Gllogoc ka shpërndarë njoftimin e pranuar nga Agjencia për Barazi Gjinore për masat e veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy Bashkëshorteve deri në prill 2020 si dhe ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Zyra për studime gjinore me temë Trashëgo të kaluarën. . | |
| 5.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe** | 1.Sa raste të strehimit dhe të kompensimit të viktimave të trafikimit janë evidentuar në komunën tuaj?<br><br>2. A ka siguruar Komuna ndihmë për viktimat e kundër trafikimit ? | 1.Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Qendra për Punë Sociale në Drenas ka trajtuar gjithsej 4 viktima të trafikimit dhe atë të mitura, dy prej të cilave kanë qenë të strehuar në Strehimore.<br><br>2.Më datën: 29.11.2019, është mbajtur ligjërata vetëdijësuese e organizuar nga Zyrtarët e Stacionit Policor në Drenas me temën: Parandalimi i delikuencës së të miturve në | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Mirëqenies Sociale** | 3.A ndanë Komuna juaj fonde të qëndrueshme dhe afatgjatë për ofrimin e shërbimeve sociale?<br><br>4.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin tre-vjeqar për strehim Social. Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin? | shkolla në ttë cilën kemi marrë pjsë edhe ne si QPS.<br><br>3.Buxheti i SNS dhe Sh.S per 2019 është 21,400.00, prej tyre 15680.00 për MPMS dhe 5720 nga komuna.<br><br>4. Po e ka të aprovuar Programi Komunal Tre Vjeçar për Banim Nr. 01-400/01-21396 dt.23/04/2019. | |
| 5.7.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal | **Drejtoria për Financa dhe Buxhet** | 1. A ka ndarë komuna juaj buxhet për mbrojtjen e komuniteteve jo shumicë? Nëse po, sa është buxheti ?<br>2.A ndan Komuna juaj buxhet për personat e riintegruar? | 1.Komuna jonë nuk ka ndarë buxhet për komunitete pakicë sepse nuk kemi komunitete pakicë.<br><br>2.Komuna për të riatdhesuarit ka projekte kryesisht në sektorin e bujqësis për perkrahje të riatdhesuarve, ku ju janë ndarë motokultivator ,fidane të bimëve mjekuese aromatike. | |
| 5.8.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve | **Zyra ligjore/Zyra informimit** | 1.A është rekrutuar stafi i nevojshëm dhe profesional për përkthim?<br><br>2. Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime | 1.Jo ,Komuna nuk ka rekrutuar staf për përkthim.<br><br>2.Me vendim Kryetari i Komunës ka formuar një komision prej 3 anëtarësh për përkthim në gjuhët zyrtare pasi që Komuna e Gllogoc/it sic | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët që përdoren nga komunitetet jo shumicë në komunën tuaj? | jeni ne dijeni përbehët vetëm nga komuniteti shqiptar . | |
| 6.MBROJTJA DHE PROMOVIMI TRASHËGIMISË KULTURORE | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6.1.Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore | **Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)** | 1. Cilat janë veprimet/ aktivitetet që komuna juaj ka ndërmarrë lidhur me definimin dhe trajtimin e perimetrave, zonave të mbrojtura, sipërfaqeve të mbrojtura dhe shenjëzimin e aseteve të Trashëgimisë Kulturore? ( te ndahet veq e veq) | 1. Aktivitetet që Komuna i ka ndërmarrë lidhur me definimin dhe trajtimin e perimetrave, zonave të mbrojtura, sipërfaqeve të mbrojtura dhe shenjëzimin e aseteve të Trashëgimisë Kulturore Vendosja e shenjave identifikuese ( Tabelave), Identifikimin e monumenteve të TKK-së pjesrisht. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore | | 1. A ka komuna juaj Plan për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ? Nëse po Ju lutem ti bashkangjitni Planin? | 1.Jo nuk ka Plan, përveq listës së përfshirë në Planin Zhvillimor Komunal 2008 – 2020+ dhe në planin afatmesëm 8 vjeçar që është në përpunim. | |
| | | 2. A ka komuna juaj Planin e Veprimit për trashëgimi kulturore. Nëse po Ju lutem ti bashkangjitni Planin? | 2.Plan të veprimit nuk ka përveq vizitave të identifikimit të monumenteve të TKK-së. | |
| | | 3. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura? | 3.Nuk ka shkelje dhe ndërtime ilegale në zonat e mbrojtura. | |
| | **Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)** | 4. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura? | 4.Nuk janë ndërmarrë masa pasi që nuk ka pasur shkelje . | |
| | | 5. A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive te objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ? | 5.Jo. | |
| | | 6. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? **(Vetem komunat qe kanë kisha)** | 6.Jo. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore | **Drejtoria e Kulturës** | 1.Cilat janë aktivitetet që komunat kanë ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?<br><br>2. Cilat janë format e bashkëpunimit me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore? | 1. Komuna nuk ka ndërmarrë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe promovimin e mbrojtjes së trashëgimisë( vetëm përmes broshurave informuese ).<br><br>2.Nuk ka bashkëpunim të mjaftueshem. | |
| **2. BLLOKU II: KRITERET EKONOMIKE** | | | | |
| **1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT** | | | | |
| 1.1. Lehtësimi i procedurave të bërjes biznes në komuna | **Drejtoria për Zhvillim Ekonomik** | 1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunën tuaj ? | 1.Qendra Komunale ONE STOP SHOP është themeluar me datën 28.06.2011. | |
| 1.2. Përmirësimi i mëtejmë i ambientit në të bërit biznes | **Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizem** | 1.Sa është numri i bizneseve të regjistruara, ju lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2019 ?<br><br>2.Sa është numri i bizneseve të mbyllura, ju | 1.Numri bizneseve të regjistruara për periudhën Janar-Dhjetor 2019 ëtë 241 biznese.<br><br>2.Numri i bizneseve të mbyllura për periudhën Janar-Dhjetor është 21 biznese. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2019 ?<br><br>3. Sa është numri i bizneseve të udhëhequr nga gratë?<br><br>4.Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për subvencionimin e bizneseve?<br><br>5. Sa është numri i inspektorëve të tregut në komunen tuaj? | 3.Numri I bizneseve të udhëhequra nga grate pë ketë periudhë është 49.<br><br>4.Për këtë periudhë raportuese Komuna nuk ka ndarë buxhet pë subvencionimin e bizneseve.<br><br>5.-Inspektoret janë në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit Komunal , 2 inspektorë tregu. | |
| 1.3.Procedurat e planifikimit të buxhetit nuk kanë qenë transparente dhe të koordinuar deri më tani. Programet e shpenzimeve të buxhetit nuk janë përputhur me prioritetet afat gjata të qeverisë. | **Drejtoria për Financa dhe Buxhet** | 1.Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit? (të raportohet në K4)<br><br>2. Cilat janë format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit në planifikimin e buxhetit? | 1.Komuna për hartimin e buxhetit për vitin 2020 dhe parashikimeve për vitet 2021 dhe 2022 ka mbajt 7 degjime buxhetore, 1 degjim është mbajt në sallën e kuvendit të komunës dhe 6 takime janë mbajt neper bashkësi lokale.<br><br>2. Komuna gjatë hartimit të buxhetit ju bënë thirrje të gjithë qytetarve shoqrisë civile dhe grupev tjera të interesit që të kyqen në planifikimin e buxhetit, ku siq cekem më lart janë bër shtat takime buxhetore neper bashkësi lokale,dhe prioritet ju ipet nevojav të qytetarve | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | neper bashkësi lokale sipas prioritetev qe ata i caktojn. | |
| **2. KAPITULLI 16 I ACQUIS-SË: TATIMET** | | | | **Neni 105 Tatimet – MSA** |
| 2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal; | **Drejtoria e Inspektoriati t** | 1. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale? | 1. Masat që ka ndërmarrë komuna ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale janë :Verifikimi i regjistrimit të bizneseve, Deklarcionin e mallit ,afatizimi i produkteve ushqimore , pajisja e bizneseve me pelqime për ushtrimin e veprimtarisë. | |
| 2.2. Avancimi dhe zbatimi i kornizës ligjore për ofrimin e shërbimeve publike, procedurave administrative dhe kontrollimin e kualitetit të tyre ( Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal) | | 1.A ka komuna juaj Strategji për zhvillim ekonomik lokal, nëse po për çfarë periudhe si dhe ju lutem të bashkangjiteni strategjinë e miratuar? ?<br><br>2. A monitorohet zbatimi i Strategjis për Zhvillim Ekonomike Lokale, nëse po ju lutem të bashkangjiteni raportet e monitorimit? | 1.Po posedon me Strategji per zhvillim ekonomik lokal prej vitit 2015 deri ne fund te vitit 2019, ndërsa tani eshte formuar grupi punues per hartimin e strategjise per zhvillim ekonomik. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2.3. Zbatimi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike | | 1. Cilat janë veprimet që komuna i ka ndërrmarrë për përmisimin e menaxhimit të financave lokale (sipas rekomandimit të auditorit) ?<br><br>2. A ka plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve të Auditorëve komuna juaj ? | 1.Veprimet të cilat i ka ndërmarrë Komuna për përmirësimin e menaxhimit të financave lokale ka formuar Komisionin për implementimin e rekomandimeve të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA).<br><br>2.Po është Plani i implementimit duke u bazuar në rekomandimet e Auditorëve. | |
| 2.4. Planfikimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal | | 1.A ka regjistër të pronës komunale komuna juaj? | 1.Po ka regjistër të pronës komunale i cili regjistrohet në sistemin SIMFK-së dhe në vlerën nën 1000 euro në regjistrimin e-Pasuria. | |
| **3. KAPITULLI 20 I ACQUIS-SË: NDËRMARRJET DHE POLITIKAT E INDUSTRISË** | | | | |
| 3.1.Ndërtimi i një infrastrukture fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve në | | 1. A është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike në komunën tuaj ?<br><br>2.Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për reduktimin e barrës administative (p.sh. racionalizimin e lejeve e licencave, etj.) në kuadër | 1.Po është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike.<br><br>2.Ka filluar hartimi i Rregullorës së re për lehtësimin e veprimit të bizneseve në Komunën tonë. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | të fushëveprimit të kompetencave të saj? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra. | | |
| **3. BLLOKU III: STANDARDET EVROPIANE** | | | | |
| **1.KAPITULLI 11 I ACQUIS-SË: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL** | | | | **Neni 26 i MSA-së: Bujqësia dhe Peshkataria** |
| 1.1.Zhvillimi i mëtejshëm i politikave në fushën e bujqësisë, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar | **Drejtoria për Bujqësi** | 1. A ka hartuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar? | 1.Po Komuna ka hartuar Plan Programin e Punës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. | |
| 1.2.Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore | **Drejtoria për Bujqësi** | 1. Sa është numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës?<br><br>2. Sa është numri i vendimeve të miratuara për ndërrimin e destinimit të tokës? | 1.Një kërkesë .<br><br>2.Asnjë. | |
| 1.3.Konsolidimi i mëtejmë i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi | **Drejtoria për Bujqësi** | 1.A janë funksionalizuar qendrat informative për trajnimin e fermereve në komunën tuaj? | 1.Po. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dhe zhvillim rural | | 2.A ka mbështetur komuna juaj fermerët në sektorin e drithrave, hortikultures dhe blegtorisë, nëse po ju lutem cekni sektorin dhe numerin e fermerëve të përkrahur? | 2. Në hortikultur -Motokultivator me freza dhe në perim kultur me serra<br>(100 Motokultivator me freza dhe 93 serra )<br>- Në bazë të memorandum bashkëpunimin në mes të Komunes dhe IADK-së për BMA si dhe programin për të Riatdhesuar kan shpërnda motokultivator , fidane të bimëve mjekuese aromatike , si dhe mjete bashkangjitse .<br>- Në Blegtori janë furnizuar fermeret me koshere dhe bletë. | |
| **2.KAPITULLI 12 I ACQUIS-SË: POLITIKAT E SIGURISË SË USHQIMIT, FITOSANITARE DHE ATO TË VETERINËS** | | | | |
| 2.1.Përmirësimi i mbrojtjes së shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve | **Drejtoria për Bujqësi** | 1.Sa është numri i fermerëve të trajnuar për mirëqenien e kafshëve? | 1.Numri i fermerëve të trajnuar për mirëqenien e kafshëve 560 fermerë. | |
| **3. KAPITULLI 15 I ACQUIS-SË: ENERGJIA** | | | | **Neni 114 Energjia- MSA** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe sigurisë bërthamore dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqiencë të Energjisë, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?<br><br>2. Sa është numri i trajnimeve të mbajtura për zyrtarët komunal për zbatimin e masave të dala nga Planet Komunale për Efiçiencë të Energjisë? | 1.Komuna e Drenasit ka të miratuar Planin për Efiqencë të Energjisë 2019-2021 në mbledhjen e mbajtur më dt.30.10.2019 .Nr. i por.060-01-63505 dt.30.10.2019<br><br>2.Numrii trajnime të mbajtura janë (2)Dy. | |
| 3.2. Ka pasur përparim në planifikimin e efiçiencës së energjisë në komuna, por nevojat e kapaciteteve lokale duhet forcuar | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1.Cilat janë aktivitetet konkrete për zbatimin e planit për efiçiencë të energjisë, specifikoni së paku tri projekte? | 1. Aktivitetet konkrete për zbatimin e planit për efiçiencë të energjisë<br><br>-Janë hartuar projekte zbatuese nëpër shkolla, ku do të implentohen këtë vit, në bashkëpunim me AKEE-së.<br>-Është instaluar softveri EMNASOFT dhe janë futur të gjitha shënimet e objekteve shkollore, shëndetsore, publike dhe ndriqimit publik.<br>-Është në përfundim hartimi i PKVEE-së.<br>1.Renovimi i objektit të Shhkollës së Mesme "Femi Lladrovci"Drenas është bërë termo izolimi,ndrrimi i dritarve dhe izolimi i kulmit me mas ofiçencë.<br>-Renovimi i objektit të SHFMU"Mehmet Gradica"në Gradicë me masa efiqente(termoizolimi i jashtem,ndrrimi i dritareve dhe izolimi i dyshemesë.<br>-Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik më trupa efiçent në rrugët e Drenasit. | |

| 4. KAPITULLI 23 I ACQUIS-SË: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.1.Promovimi i mundësive të barabarta dhe lufta kundër diskrimimit | **Njësia për të Drejtat e Njeriut** | 1.A është caktuar zyrtari për mbrojtjen nga diskriminimi në komunën tuaj? | 1.Jo, nuk është caktuar, mirëpo kjo fushë mbulohet nga Zyrtari për Barazi Gjinore. | |
| 4.2.Incimi i funksionalizmit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar | | 1.A është themeluar Komiteti konsultative për Personat me Aftësit të Kufizuar në komunën tuaj ? | 1.Po, është themeluar Komiteti konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara. | |
| 4.2.Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie | **Drejtoria e Administratës** | 1. A janë themeluar në komunë tuaj Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike ?<br>2. Sa është numri i personave të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike falas ? | 1.Zyrë për ndihmë juridike falas nga Komuna nuk ka, por nga Agjencia për ndihmë juridike falas është caktuar 1 zyrtar i cili që nga Dhjetori i vitit 2018 e deri më tani vepron tek Qendra për Punë Sociale/Komuna Gllogoc dhe ofron shërbime për ndihmë juridike falas .<br>2.Numri i personave të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike falas gjatë kësaj peridhe është 25 kërkesa, prej tyre 24 administrative dhe 1 civile janar-qershor,ndërsa qershor-dhjetor jan gjithsej 51 kërkesa në zyrën për ndihmë juridike falas. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| 4.3. Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale | **Drejtoria e Administratës** | 1. A është caktuar zyrtari komunal për mbrojtjen e të dhënave personale?<br><br>2. A është funksionalizuar baza e të dhënave personale për zyrtarët komunal? | 1.Po,është i caktuar Zyrtari Komunal për Mbrojtjen e të dhënave personale.<br><br>2.Është funksionalizuar baza e të dhënave personale për zyrtarët komunal. | **Neni 84 Mbrojta e të dhënave personale - MSA** |
| 4.4. Duhet siguruar që Zyrat Komunale të Gjendjes Civile (ZKGJC) dhe zyrat e vendit të plotësojnë kriteret e sigurisë për regjistrimin civil, por edhe kriteret e ruajtjes dhe mbajtjes së | **Drejtoria e Administratës** | 1.A është ngritur siguria fizike e dokumentacionit (roja fizike, vendosja e kamerave, grilat, kasafortat,etj.)?<br><br>2. A mbahen librat fizik në komunën tuaj? | 1.Po,në Komunën tonë është ngritur siguria fizike e dokumentacionit, rojet fizike, hapësira punuese është nën vëzhgimin e kamerave, grilat etj.<br><br>2.Po, mbahen librat fizikë në Komunë . | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dokumenteve personale | | | | |
| 4.5. Verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar, respektivisht tek gjendja civile në komuna, si dhe përmes Zyrës për Komunitete dhe Kthim (ZKK) dhe Komisionit Komunal për Ri-integrim | **Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim** | 1. A është funksionale Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ?<br><br>2.Kush e bënë verifikimin e kërkesave të personave të riatdhesuar ? | 1. Po, është funksionale Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe për punën e saj i raporton Zyrës së Kryetarit.<br><br>2.Zyrtari Komunal për Komunitete dhe Kthim e bënë verifikimin e kërkesave të personave të riatdhesuar. | |
| 4.6. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur | Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale | 1.Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj?<br><br>2. Sa është numri i shtëpive të rindërtuara për të rikthyerit?<br><br>3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim? | 1. Numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në Komunë është 6 (gjashtë).<br><br>2.Nuk është bërë rindërtim i shtëpive për të rikthyerit.<br><br>3.Nuk ka kërkesa për këtë periudhë Janar-Dhjetor 2019. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?<br><br>5. A ka hartuar Komuna Juaj Planin Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar?<br><br>6. Sa është numri i personave të riatdhesuar të cilët janë pajisur me dokumente personale?<br><br>7. A është krijuar baza e të dhënave për përsonat e zhvendosur? | 4.Sa i përket aplikimit për plan biznes me Rregullorën 13/2017 ka kaluar tek Zyra e punësimit ku një numër i tyre kanë përfituar nga UNDP në bashkëpunim me MPB. Vlera e mjeteve të punës përfshin shumën prej 3000 €.<br><br>5. Jo ende nuk është hartuar Plani Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm për personat e riatdhesuar.<br><br>6.Gjatë kësaj periudhe kanë qenë 21 kërkesa dhe të gjithë janë pajisur me dokumente të kthimit të cilat i kanë poseduar.<br><br>7. | |
| 4.7. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet RAE dhe përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas | **Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim** | 1.Sa është numri i personave të regjistruar nga komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian?<br><br>2. Sa është numri i fushatave të realizuara të regjistrimit falas?<br><br>3. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, | 1.Nuk ka ndonjë komunitet tjetër vetëm shqipëtar.<br><br>2.Nuk ka .<br><br>3.Jo ngase nuk ka komunitete tjera përveq Komunitetit shqipëtar. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni këtë Plan?<br><br>4.A është themeluar komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin rom, egjiptian dhe ashkali? | 4. Jo nuk është themeluar Komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin rom. | |
| **5. KAPITULLI 24 I ACQUIS-SË: DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA** | | | | **Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia- MSA** |
| 5.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafruar | **Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete** | 1. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar? | 1.Jo. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| 5.2. Të përmirësohet siguria dokumenteve, duke siguruar zbatimin e dispozitave të MSA-së dhe legjislacionit vendor | **Drejtoria e Administratës** | 1. A është përfunduar procesi i digjitalizimit të librave të gjendjes civile të kthyer nga Serbia?<br><br>2. Sa zyrtar komunal janë certifikuar (që u janë nënshtruar testit të njohurive,ligjore/procedurale, të sistemit, dhe nga gjendja civile)? | 1.Po, është përfunduar procesi i digjitilazimit të librave të gjendjes civile.<br><br>2.Komuna e Gllogocit ka gjithësej 13 zyrtarë komunal të cilët janë të çertifikuar. | |
| **6.MENAXHIMI I KUFIRIT DHE MIGRACIONIT** | | | | **Neni 85- Vizat,menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni- MSA** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6.1.Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVSB) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive | **Zyra e Kryetarit** | 1.A ëshë funksional Këshilli Komunal për siguri në bashkësi (KKSB) në komunën tuaj?<br><br>2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSB ?<br><br>3. A është funksional Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ?<br><br>4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ?<br><br>5. A është funksional Ekipi Vepruese për Siguri (EVS) në komunën tuaj ?<br><br>6. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga EVS ?<br><br>7. A janë themeluar Këshillat e Fshatrave në komunen tuaj? Nëse po a janë funksionale? | 1.Po, në Komunën e Gllogoc-it është funksional Këshilli Komunal për siguri në Bashkësi (KKSB).<br><br>2.Numri i takimeve të mbajtura nga KKSB është gjithsej 6 dhe në është thirrur për datën 18.12.2019.<br><br>3.Po, në Komunën e Gllogoc-it është funksional Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP).<br><br>4.Numri i takimeve të mbajtura nga KLSP është 4 .<br><br>5. Po, në Komunën e Gllogoc-it është funksional Ekipi Veprues për Siguri (EVS) .<br><br>6.<br><br>7. Po në Komunën e Gllogoc-it janë themeluar Këshillat e fshtrave dhe të njëjtat janë funksionale. | |
| 6.2. Të dëshmohen rezultate konkrete në | **Drejtoria për Shëndetësisë** | 1.Çfarë aktivitete janë ndërmarrë nga komuna, | 1.Drejtoria Komunale e Arsimit ne bashkepunim me Drejtorin e kultures rinis dhe sportit dhe bashkepunim | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| fushën e luftimit të narkotikëve | **dhe Mirëqenies Sociale/Drejtoria e Arsimit/Policia e Kosovës** | në luftën kundër drogave dhe parandalimit të trafikimit të narkotikëve? | edhe me OJQ kane mbajtur aktivitete ne institucionet arsimore per luften kunder drogavr dhe trafikimit te narkotikeve, ndërsa DKA Gllogoc sipas planprogramit të IKK/MASHTIT ka si projekt nga mësimdhënësit e edukatës fizike kryesisht tema duhani dhe lëndët narkotike, porjket ky i cili realizohet gjate vitit shkollor ne muajin shkurt dhe mars dhe i dedikohet nxënesve te klasave të 8,9 dhe 11 ndërsa Zyrtarët e Qendres për Punë Sociale ë datën: 26.02.2019 kanë mbajtur trajnim me temën: Përdorimi i substancave narkotike tek të miturit dhe metodat e këshillimit psiko-social, në të cilin kanë marrë pjesë edhe QPS. Organizator i këtij trajnimi ka qenë Organizata Terre des homes. | |
| **7. KAPITULLI 26 I ACQUIS-SË: ARSIMI DHE KULTURA** | | | | **Neni 107 Arsimi dhe trajnimi - MSA** |
| 7.2. Zbatimi i planit të veprimit nga Strategjia ndërministrore për shkollat promovuese të shëndetit 2009-2018 | **Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale/Drejtoria e Arsimit** | 1. A janë ndërmarrë aktivitetet vetëdijësuese në shkolla për shëndet dhe mjedis? Nëse po, Sa ka qenë numri i pjesëmarrësve, cila ka qenë mosha, gjinia, etnia? | 1.Drejtoria e Shëndetesisë dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë në bashkëpunim me nxënës shkollat fillore dhe të mesme kanë mbajtur aktivitete vetëdijesuese për shëndetin dhe mjedisin. Gjithashtu në bashkëpunim me Drejtorin e Mbrojtjen e Ambientit kanë mbajtur aktivitete lidhur me Ditën Tokës. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7.3. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta | **Drejtoria e Arsimit** | 1. Sa është numri i nxënësve dhe studentëve përfitues të bursave nga komuna juaj ?<br><br>2. Sa është numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor? | 1.Përfitues të bursave nga Komuna e Drenasit për vitin 2019-2020 janë 40 bursa për nxënës të shkollave ndërsa për studentë ka ndarë 160 bursa .<br><br>2.FMNV(fëmijët me nevoja të veçanta)në Arsimin Gjithëpërfshirës në komunën tonë janë të vlerësuar dhe të integruar në shkollat e afërta me vendbanimin e vetë që nga fillimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ ku në total janë 78 fëmijë,po ashtu ekipi ka vlerësuar edhe 9 fëmijë që priten të integrohen në institucione kopshte të fëmijëve. Prej numrit të përgjithshëm të fëmijëve për integrim në institucione parashkollore janë 18 fëmijë. | |
| 7.4. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti RAE. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit | **Drejtoria e Arsimit** | 1.Sa është numri i braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë?<br><br>2. A ka hartuar komuna jual Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali), nëse po ju lutemi të bashkangjiteni këtë Plan? | 1.Nuk ka raste të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë<br>(ngase nuk kemi komunitete jo shumicë).<br><br>2.Komuna nuk ka Plan të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit për komunitetet jo shumicë.(ngase nuk kemi komunitete jo shumicë). | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 3. A janë formuar ekpiet per parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla në komunen tuaj? | 3.Po në Shkolla janë formuar ekipe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2012 EPRBM.<br>Po ashtu edhe në Drejtorinë Komunale të Arsimit është formuar ekipi në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ nr 19/2012. | |
| 7.5. Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës së tregut të punës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave | | 1. Sa shkolla profesionale janë në komunën tuaj (specifikoni drejtimet/profilet)?<br><br>2. Sa është numri i nxënesve të braktisjes së shkollimit ? | 1.Në Komunën e Gllogoc-it është vetëm një shkollë profesionale me këto drejtime/profile : Eketroteknikë (teknik i elektros,tek.i komunikacionit, tek. I informatikës, tek.i mekatronikës), Makineri (ngrohje dhe klimatizim,, transport rrugor, Automekanik,operator i prodhimit) , Ekonomi (Kontabilitet, banka dhe sigurime), Mjekësi (farmaci, infermieri,), Ndërtimtari (arkitekturë), Kimi Teknologji (teknologji ushqimore, laborant i kimisë, teknik i riqarkullimit), Dizajn(konfeksion), Bujqësi ( hortikulturë), Metalurgji ( përfitues i metaleve), Gjeologji.<br><br>2.Janë dy (2) nxënës të cilët kohë pas kohe e braktisin shkollën dhe kthehen përseri . | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| 7.6. Përmirësimi i sigurisë rrugore. Ulja e aksidenteve për 20%, krahasuar me vitin paraprakë | Drejtoria e Arsimit/ Zyra e Kryterit | 1.Çfarë veprime ka ndërmarr komuna sa i përket vetëdijesimit në shkolla në edukimin për siguri rrugore?<br><br>2.A ka ndare komuna juaj subvencione për OJQ apo ka bashkëpunuar me ndonjë projekt sa i përket kësaj fushe? | | |
| **8. KAPITULLI 27 I ACQUIS-SË: MJEDISI** | | | | **Neni 115 Mjedisi- MSA** |
| 8.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1.A është hartuar plani për menaxhimin e mbeturinave komunale, nëse po ju lutemi na | 1.Po është hartuar Plani për Menaxhimin e mbeturinave komunale.<br>https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2018/07/Plani-komunal- | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | bashkangjiteni planin e miratuar ?<br><br>2. Cfare aktivite ka ndërmarrë komuna e juaj për zbatimin planit për menaxhimin e mbeturinave komunale?<br><br>3. A është hartuar plani i veprimit për cilësin e ajrit në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar? | per-menaxhim-te-mbeturinave.pdf<br><br>2.Komuna ka ndërmarr disa aktivitete për zbatimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave komunale si : ---<br>-Eleminimi i deponive ilegale.<br>-Zgjerimi dhe plotësimi i ekonomive familjare më kontinjer 120 L,plotësimi i pilot zonave për ndarje të mbeturinave më kontinjer prej 240 L,në lokalitetet Qendër të Drenasit,Çikatovë e Re,Lagjëja e Feronikelit,Komoran e Poklek i Ri.<br>-Rregullimi i një pjese të platos së deponisë së transferit më Zhavor dhe vendosja e preses për paketim të mbeturinave të reiciklueshme etj.<br><br>3..Është hartuar dhe gjendet në debat publik. | |
| 8.2. Ngritja e kapaciteteve administrative në nivelin lokal, për zbatimin e ligjit për mbeturina | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. Sa është numri i stafit të trajnuar ? | 1.Nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë janë trajnuar 4 persona si dhe 4 zyrtarë të tjerë. | |
| 8.3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1.Sa është numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave? | 1.Nga Komuna janë ndërmarrë 3 fushata për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave në bashkëpunim me GIZ-IN dhe GAC-in. | |
| 8.4. Përmirësimi i qasjes, cilësisë, qëndrueshmërisë financiare të performancës mjedisore | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. A është përgatitur vlerësimi dhe plani reformues i sektorit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta? | 1.Po është hartuar Plani i reformës për menaxhimin e mbeturinave të ngurta. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të sektorit të menaxhimit të mbeturinave | | 2. A është përgatitur inventari për mbeturina të rrezikshme dhe vlerësimi i gjendjes? | 2.Jo, kjo problematikë për mbeturina të rrezikshme është zgjidhur përmes Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa për mbetjet tjera ende nuk është përgatitur inventari. | |
| 8.5.Zbatimin i masave për mbrojtjen e Zonave Ujore Sanitare | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. A ka përfshirë komuna e juaj zonat e mbrojtura ujore sanitare në Planin Rregullues detajore? | 1.Jo, kjo problematikë për mbeturina të rrezikshme është zgjidhur përmes Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa për mbetjet tjera ende nuk është përgatitur inventari. | |
| 8.6. Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi? | 1.Plani Rregullues detajor përfshinë vetëm qendrën e qytetit dhe nuk përfshinë zonat e mbrojtura ujore sanitare. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8.7. Direktiva nr. 2002/49/KE lidhur me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis | Drejtoria e Inspektoriatit / | 1. Sa ankesa kanë qenë nga qytetarët për prishje te rendit dhe qetësisë për pengesa të zhurmës së krijuar në ambiente publike ?<br><br>2.Çfarë masa janë ndërmarr nga Inspektorati Komunal ?<br><br>3.A ka komuna juaj instrument per matjen e zhurmës?<br><br>4.Sa dënime janë bere mbi prishjen e rendit dhe qetësisë se zhurmës në ambiente publike?<br><br>5.A janë te njoftuara lokalet afariste deri ne çfarë mase është e lejushme sipas ligjit ne fuqi ngritja e zërit dhe ne cilat orare lejohet ?<br><br>6.Cilat janë sfidat e drejtorisë suaj dhe bizneseve lokal për mos zbatimin e këtij ligji ? | 1.Për prishje të rendit dhe qetësisë kemi pasur një (1) ankesë.<br><br>2.Me procesverbal i është terhequr nga inspektori i mjedisit , respektimi i ligjit mbi zhurmën, si dhe izolimi i objektit për zvoblimin e zhurmës.<br><br>3.Jo nuk ka.<br><br>4. Asnjë denim.<br><br>5. Me procesverbal janë të njoftuara të gjitha lokalet – kafiterit qe prodhojn zhurmë .<br>Me ligjin mbi zhurmën ,zhurma nuk lejohet nga ora 22 deri në ora 7 e mengjesit. Zhurma lejohet vetem ne ahengje dhe festa me një vendim te veqant.Norma e lejuar është deri në 35Db<br><br>6.Parandalimi i zhurmës ,si dhe respektimi i legjislacionit. | |

| 9. BUJQËSIA DHE PESHKATARIA | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 9.1. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore | Drejtoria e Inspektoratit | 1.A ka komuna juaj inspektor te bujqesise?<br><br>2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara?<br><br>3. Sa është numri i lejeve të lëshuara?<br><br>4. Sa është numri i inspektimeve?<br><br>5. Sa është numri i fletëparaqitjeve të parashtruara? | 1. Nuk ka inspektor të Bujqësisë.<br><br>2.Numri i kërkesave në të gjithë sektoret e inspekcionit është 122.<br><br>3.Numri i LMK-le (Leje Mjedisore Komunale) të lëshuara është 10.<br><br>4.Numri i inpektimeve në të gjithë sektoret e inspekcionit është 1181.<br><br>5.Numri i fletëparaqitjeve nga tëgjithë sektoret i inspekcionit është 6. | |
| 9.2. Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi) | Drejtoria e Bujqësisë | 1.A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ? | 1.Është duke u hartuar plani i menaxhimit të tokave rurale - bujqësore. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **10.ZHVILLIMI RAJONAL** | | | | **Neni 119 Zhvillimi rajonal- MSA** |
| 10.1.Pjesëmarrja e komunës në programet e BNK-së (bashkëpunimit ndërkufitar) | **Zyra e Kryetarit të komunës** | 1.Sa është numri i projekteve të BNK-së që komuna është pjesëmarrëse? | 1.Numri i projekteve të BNK-së për këtë periudhë raportuese është 2. | |
| 10.2.Marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-komunaldhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar | **Zyra e Kryetarit të komunës** | 1.Sa është numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër-komunal gjatë periudhës së raportimit?<br><br>2.Sa është numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar? | 1.Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër-komunal gjatë periudhës raportuese është 7 .<br><br>2.Nuk ka . | |
| **11.KAPITULLI 28 I ACQUIS-SË: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT PUBLIK** | | | | **Neni 81 Mbrojtja e konsumatorit- MSA** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 11.1.Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues | **Drejotria e Administrate s/Drejtoria e shëndetësis** | 1. Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës? | 1..Programi për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës është projekt në Kujdesin Parësor Shëndetsor përmes Qendrës Kryesore e Mjekësis Familjare nga Zyra e UNICEF-it programeve këshillimore për shëndetin e nënës dhe fëmijës gjatë 3 muajve të fundit. | |
| 11.2. Mbrojtja e Shëndetit Publik | | 1. Sa është numri i inspektimeve për zbatimin e Ligjit kundër duhanit dhe numri i gjobave të shqiptuara gjatë periudhës raportuese? | 1.Për zbatimin e Ligjit kundër duhanit gjatë periudhës raportuese numri i inspektimeve është 180,114 procesverbale, 36 gjoba mandatore,8 gjoba ndaj personave fizik dhe 28 gjoba ndaj personave juridik/personave përgjegjës të lokaleve. | |